

KRYESIA

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2024

VENDIM

**“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE RREGULLAVE
PËR PROPOZIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E KANDIDATURAVE
PËR DEPUTET TË PARTISË DEMOKRATIKE”**

Në mbështetje të neneve 10, 12, 44 dhe 45 të Statutit të PDSH-së, me qëllim përcaktimin e procedurave për propozimin, konsultimin dhe përzgjedhjen e kandidaturave për Deputet të Partisë Demokratike. Kryesia e Partisë në mbledhjen e datës __ Mars 2024.

VENDOSI

- Të fillojë procesin e propozimit, konsultimit dhe përzgjedhjes së kandidaturave për Deputet të Partisë Demokratike.
- Procesi duhet të jetë transparent, gjithëpërfshirës dhe me synim maksimalizimin e votave. Ai duhet të realizohet pa asnjë paragjykim për personat e propozuar.
- Kandidatët e Partisë Demokratike për përfaqësim politik për Deputet duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara në Aneksin A, bashkëlidhur këtij vendimi.
- Propozimin dhe përzgjedhja e kandidaturave bëhet bazuar kriteret dhe në analizën e kombinuar të faktorëve të parashikuar në Aneksin B bashkëlidhur këtij vendimi.
- Në procesin e propozimit si kandidatura gjatë procesit të konsultimit nga Degët e Partisë nuk përfshihen anëtarët e zgjedhur në organet qendrore të partisë: Antarët e Këshillit Kombëtar, Kolegjit të Kryetarëve dhe Kryesisë së PDSH si persona të konsultuar dhe votuar më parë nga antarësia dhe struktura.
- Për ndjekjen e procesit të propozimit të kandidaturave në Degë ngarkohen Grupet e Punës, të miratuar me urdhër të Kryetarit të Partisë, sipas Degëve dhe Qarqeve përkatëse.
- Brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, në prezencë të anëtarit të Deleguar të Grupit të Punës, zhvillohet mbledhja e Kryesisë në çdo Degë të Partisë për fillimin e procesit të konsultimit me antarësinë dhe miratimin e kalendarit të takimeve konsultative dhe caktimin e datës së mbledhjes së Kryesisë së Degës të Partisë, në të cilën do të propozohen kandidaturat për deputetë. Mbledhja për propozimet zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga mbledhja e parë.

8. Kryetarët e Njësive zhvillojnë menjëherë konsultime dhe marrin mendimin e anëtarësisë së Njësive përkatëse për kandidaturat që mund të propozojnë në mbledhjen e Kryesisë së Degës.
9. Brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi zhvillohet mbledhja e Këshillit Koordinues të Qarkut në të cilën bëhet seleksionimi i kandidaturave të propozuara nga Kryesitë e Degëve. Funkzioni i Drejtuesit Politik të Qarkut ushtrohet kolektivisht nga anëtarët e Kryesisë së PDSH të deleguar në Qarkun përkatës. Këshilli Koordinues i Qarkut miraton një listë kandidaturash me një numër jo më të madh se $\frac{1}{2}$ e numrit të deputetëve që zgjidhen në Qark. Formularët e plotësuar të kandidimit dorëzohen pranë Sekretariatit Ekzekutiv për Organizimin, jo më vonë se 20 ditë nga miratimi i këtij vendimi.
10. Jo më vonë se 5 ditë nga dorëzimi i kandidaturave Sekretariati Ekzekutiv i paraqet Kryetarit të Partisë raportin përmbledhës me kandidaturat e ardhura nga Degët.
11. Kryetari i Partisë e plotëson listën me kandidaturat e tjera dhe harton listën përfundimtare të kandidaturave dhe ja propozon atë Kryesisë së Partisë.
12. Kryesia e Partisë vendos listën përfundimtare të kandidaturave elektorale për Kuvendin e Shqipërisë e cila paraqitet për miratim në Këshillin Kombëtar.

Partia Demokratike e Shqipërisë

Kryetari

Sekretari i Përgjithshëm

Lulzim Basha

Enkelejd Alibeaj

ANEKSI A

1.

138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar”;

- ç) në periudhën 29.11.1944 - 02.07.1991 të mos ketë qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i Degëve të Punëve të Brendshme, punonjës i organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit apo i favorizuar, anëtar i Komisionit të Dëbim-Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese politike.

ANEKSI B

1. Procesi i propozimit dhe konsultimit së kandidaturave mban në konsideratë:
 - a. përfaqësimi i grave duhet të jetë jo më pak se 30 % e numrit të përgjithshëm të kandidatëve.
 - b. përfaqësimi i të rinjve të jetë jo më pak se 10 % e numrit të përgjithshëm të kandidatëve.
 - c. përfshirjen e përfaqësuesëve të të përndjekurve politikë apo pronarëve, përfaqësues të sipërmarrjes si dhe prurjeve të reja nga bota akademike apo shoqëria civile.
2. Propozimin dhe përzgjedhja e kandidaturave bëhet bazuar në analizën e kombinuar të faktorëve të mëposhtëm:
 - a) aktivizimit në jetën politike e publike të vendit, si dhe mbrojtjes në vazhdimësi të interesave, vlerave dhe programit të PDSH-së
 - b) reputacionit në radhët e anëtarësisë së partisë dhe komunitetit në tërësi.
 - c) kontributit profesional e politik në parti apo promovimit të vlerave themelore që udhëheqin PDSH-në;
 - ç) kontributit në fushatat elektorale për Partinë Demokratike.
 - d) kohëzgjatjen e anëtarësimit në parti.